



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KOMUNA MITROVICA E VERIUT : OPŠTINA SEVERNA MITROVICA MITROVICA NORTH MUNICIPALITY			
Njesia Org. Org. Jedin. Org. Unit.	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. Nr.	792-031
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	27	Data Datum Date	11/10/23

## Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

### Komuna e Mitrovicës Veriore

Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North

---

#### KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS VERIORE

Nr. \_\_\_\_\_ . Data: 11.10.2023.

Mitrovicë Veriore.

### RREGULLORE KOMUNALE NR. 02/2023 PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SË SUBVENCIONEVE DHE TRANSFEREVE, DHE GRANTEVE.

Tetor 2023, Mitrovicë Veriore

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika c të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë: Viti III/Nr. 28/04 Qershor 2008”), nenin 53 të Ligjit Nr. 03-L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë: VITI III / Nr. 27 / 03 QERSHOR 2008), dhe Ndryshim – Plotësimet e këtij Ligji, nenin 36 të Rregullores Financiare 01/2013 – MF – Shpenzimi i Parave Publike, dhe nenin 15, paragrafi 15.1 të Statutit të Komunës së Mitrovicës Veriore data 15.05.2014, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës Veriore në mbledhjen e mbajtur më 10.10.2023, miraton këtë:

**RREGULLORE KOMUNALE NR. 02/2023**  
**PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SË**  
**SUBVENCIONEVE DHE TRANSFEREVE, DHE GRANTEVE**

**PJESA E PARË**  
**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi dhe Fushëveprimi**

1. Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat të cilat i mundësojnë Komunës së Mitrovicës Veriore ndarjen e mjeteve financiare pa kthim, nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve për fushat e cekura në këtë rregullore për personat fizik dhe juridik, dhe ndarjen e granteve, si dhe vendosjen e një sistemi transparent dhe llogaridhënës për financimin dhe subvencionimin e projekteve, aktiviteteve si dhe dhënies së ndihmës për nevoja të ndryshme për qytetarët që janë banor rezident të Komunës së Mitrovicës Veriore.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga organet komunale gjatë ndarjes së subvencioneve dhe granteve për përfituesit.

**Neni 2**

**Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
  - 1.1 **Komuna dhe organet e saj** – ka kuptimin siç është përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale;
  - 1.2 **Subvencion** – konsiderohet mbështetja e njëanshme dhe e pakthyeshme me mjete financiare, të cilat mjete barten nga buxheti i Komunës, në llogarinë rrjedhëse të përfituesve.
  - 1.3 **Transfer** – konsiderohet pagesa e njëanshme, jo të kthyeshme për institucionet joprofitabile, familjet dhe individët.

**1.4 Grant** – konsiderohet ndihma e dhënë nga Komuna, në formën e transferimit të mjeteve financiare apo paisjeve/mekanizmit tek personi fizik apo juridik, e cila kushtëzohet me qëllim të plotësimit në të ardhmen të kushteve të pëcaktuara në Kontratë dhe si kusht që këto mjete/paisje/mekanizëm t'i përdorin për veprimtaritë që është përzgjedhur.

**1.5 Pagesa e pakthyeshme** - është e njëanshme, atëherë kur nuk ka mallra dhe shërbime që rrjedhin si kompensim ose kundërvlerë për pagesën.

**1.6 Përfituesi** - nënkupton personat fizik dhe juridik që përfitojnë mjete financiare nga kategoria e subvencioneve, transfereve dhe granteve të planifikuara në Buxhetin e Komunës dhe në pajtim me Ligjin për Ndarjet Buxhetore.

**1.7 Person juridik** – në këtë rregullore nënkupton ndërmarrjet private (bizneset private) që janë të regjistruara në komunën e Mitrovicës Veriore dhe veprojnë në këtë Komunë dhe fermerët që operojnë si biznes (agrobizneset).

**1.8 Person fizik** – nënkupton qytetarin e Komunës së Mitrovicës Veriore, i cili aplikon për subvencionim në bazë të kërkesës së parashtruar dhe të argumentuar.

**1.9 Banor rezident** - nënkupton personi që jeton dhe vepron në Komunën e Mitrovicës Veriore, dhe posedon dokumentacion valid të Republikës së Kosovës.

**1.10 Marrëveshje/Kontratë** – nënkupton dokumentin e nënshkruar ndërmjet Komunës dhe përfituesit, në të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.

**1.11 Komision** – nënkupton komisionet të cilat themelohen nga Kryetari i Komunës me qëllim të shqyrtimit të Kërkesave/Projekteve të cilët aplikojnë për subvencione dhe grante.

**1.12 Pagesa Direkte** – nënkupton pagesën e dhënë drejtëpërdrejtë fermerit për njësi të sipërfaqes, krerë lopë, dele dhe dhi, koshere bletësh, dhe litër qumështi.

### **Neni 3**

#### **Kufizimet mbi ndarjen e subvencioneve, transfereve dhe granteve**

1. Komuna ndan subvencione dhe transfere, si dhe grante duke u bazuar në Ligjin e Buxhetit për Vitin Fiskal, për të cilën ndahen subvencionet, transferet dhe grantet, dhe atë vetëm në masën e përcaktuar në këtë ligj.

2. Personat fizik mund të përfitojnë subvencione, transfere dhe grante sipas dispozitave të kësaj rregulloreje në vlerë maksimale deri në 1,000.00 € (njëmijë euro).

3. Personat juridik, duke përfshirë fermerët që aplikojnë si person fizik dhe bizneset start-up, e që nuk funksionojnë ende si biznes, të cilët aplikojnë në Thirrje Publike, mund të përfitojnë subvencione, transfere dhe grante sipas dispozitave të kësaj rregulloreje në vlerë maksimale deri në 10,000.00 € (dhjetë mijë euro).

4. Çdo ndarje e subvencioneve, transfereve dhe granteve që e tejkalon vlerën e përcaktuar nga paragrafi 2 (dy) dhe 3 (tre) të këtij neni duhet të miratohet nga Kuvendi i Komunës.

5. Komuna ndan subvencione, transfere dhe grante për këto fusha: arsim, zhvillim ekonomik dhe turizëm, bujqësi dhe zhvillim rural, shëndetësi, rastet sociale, subvencione për radhët e komuniteteve pakicë, kulturë, rini dhe sport, barazi gjinore dhe të drejtat e njeriut, si dhe duke mos u kufizuar edhe në fusha tjera.

6. Ndarja e subvencioneve për OJQ-të do të bëhet sipas Rregullores MF-04/2017, mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

#### **Neni 4**

##### **Rregullat e përgjithshme të aplikimit për subvencione dhe grante**

1. Komuna mund të ndaj subvencione, transfere dhe grante për persona fizik dhe juridik mbi bazën e kërkesës së tyre dhe në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

2. Personi fizik dhe juridik mund të jetë përfitues i subvencioneve, transfereve dhe granteve të ndara nga Komuna nëse nuk ka obligime financiare ndaj Komunës, përveq rasteve sociale, fatkeqësive natyrore, rasteve të rënda shëndetësore, dhe rastet e dhunës në familje.

#### **Neni 5**

##### **Procedurat e përgjithshme për ndarjen e subvencioneve, transfereve dhe granteve**

1. Procedura e ndarjes së subvencioneve, transfereve dhe granteve nga Komuna mund të zhvillohet mbi bazën e Thirrjes Publike, apo në raste të veçanta në bazë të kërkesës së arsyetuar, atëherë kur lejohet me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

2. Gjatë ndarjes së subvencioneve, transfereve dhe granteve përmes Thirrjes Publike të Komunës përcaktohet qartë fusha e subvencionimit, kriteret, dokumentet e nevojshme për aplikim dhe informata tjera me rëndësi.

3. Shqyrtimi i kërkesave për ndarjen e subvencioneve, transfereve dhe granteve në bazë të Thirrjes Publike bëhet në afat brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga momenti i mbylljes së Thirrjes Publike për aplikim.

4. Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave për ndarje të subvencioneve dhe transfereve jashtë Thirrjes Publike të Komunës bëhet brenda në afat brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.

#### **Neni 6**

##### **Përjashtimet nga ndarja e subvencioneve, transfereve dhe granteve**

1. Përfitues të subvencioneve, transfereve dhe granteve të ndara nga Komuna nuk mund të jenë personat fizik të cilët nuk janë banor rezident të Komunës së Mitrovicës Veriore.
2. Personi fizik apo juridik vetëm 1 (një) herë në Vit mund të jetë përfitues i subvencioneve, transfereve dhe granteve të ndara nga Komuna.
3. Përjashtim nga paragrafi 2 (dy) i këtij neni bëjnë subvencionet, transferet dhe grantet e ndara për rastet specifike dhe të arsyetuara nga ana e Komisionit, rastet kur nuk ka aplikues të tjerë për projekte të caktuara, dhe subvencionet dhe grantet e ndara në fushën e bujqësisë.

#### **Neni 7**

##### **Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve dhe transfereve pa Thirrje Publike**

1. Kryetari i Komunës emëron komisione me mandat 1 (një) vjeçar në kuadër të secilës Drejtori/Njësi, të cilat kanë në buxhetin e tyre të planifikuara subvencione dhe transfere, e të cilët janë përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve dhe transfereve për fushën të cilën janë emëruar.
2. Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve dhe transfereve veprojnë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe dispozitat e kësaj rregulloreje, si dhe planin e punës të drejtorisë/njesisë në kuadër të së cilës janë të autorizuar për vlerësim dhe rekomandim mbi ndarjen e subvencioneve dhe transfereve, dhe mbajnë përgjegjësinë për zbatimin e drejtë të kriterëve për ndarje të subvencioneve dhe transfereve.
3. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve dhe transfereve duhet të jenë zyrtar publik, përveç të emëruarve politik në Komunë.
4. Përbërja e Komisionit duhet të jetë numër tek, ku komisioni duhet të ketë minimum 3 (tre) dhe maksimum 5 (pesë) anëtar, ku së paku 1 (një) anëtar i komisionit duhet të jetë i fushës profesionale, dhe përbërja e Komisionit duhet të bazohet mbi parimin e barazisë gjinore.

## **Neni 8**

### **Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, transfereve dhe granteve me Thirrjes Publike**

1. Kryetari i Komunës emëron komisione të përkohshme në kuadër të secilës Drejtori/Njësi, të cilët kanë shpallur Thirrjen Publike për ndarje të subvencioneve, transfereve dhe granteve për projekte të caktuara, e të cilët janë përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave/projekteve për ndarje të subvencioneve, transfereve dhe granteve duke u bazuar në kriteret e Thirrjes Publike, dhe mandati i tij përfundon në momentin e përfundimit të vlerësimit dhe publikim të listës së përfituesve.
2. Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, transfereve dhe granteve veprojnë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, dispozitat e kësaj rregulloreje, dhe kriteret e Thirrjes Publike.
3. Kryetari i Komisionit dhe anëtarët e tij për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, transfereve dhe granteve duhet të jenë zyrtar publik, përveç të emëruarve politik në Komunë.
4. Përbërja e Komisionit duhet të jetë numër tek, ku komisioni duhet të ketë minimum 3 (tre) dhe maksimum 5 (pesë) anëtar, ku së paku 1 (një) anëtar i komisionit duhet të jetë i fushës profesionale, dhe përbërja e Komisionit duhet të bazohet mbi parimin e barazisë gjinore.

## **Neni 9**

### **Vlerësimi i kërkesave dhe vendimmarrja për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve pa Thirrje Publike**

1. Komisionet bëjnë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve dhe transfereve brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh pas paraqitjes së kërkesës nga ana e palës.
2. Rekomandimet e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve dhe transfereve merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit, dhe i njëjti duhet të mbaj Procesverbal nga mbledhjet e saj, i cili duhet të nënshkruhet nga Komisioni.
3. Komisionet për vlerësimin dhe ndarjen e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të drejtorive/njërive të cilët bëjnë shqyrtim të kërkesave të ndryshme për subvencionim pa Thirrje Publike, por vetëm me kërkesë të personave fizik, siç kemi të bëjmë me rastet për kurim, pagesë të qirasë, ndihmë me pako ushqimore dhe hixhenike, marrja pjesë në gara të ndryshme brenda dhe jashtë vendit në fushën e arsimit, shkencës, kulturës, subvencionimi i fermerëve në rast të ndonjë fatkeqësie, rastet e dhunës në familje, apo fusha tjera relevante, si dhe pjesëmarrja e bizneseve të ndryshme në panairë të ndryshme që promovojnë dhe përfaqësojnë

Komunën e Mitrovicës Veriore, pas shqyrtimit të kërkesave në fjalë, të njëjtit sjellin Rekomandim për Drejtorin e Drejtorisë/Udhëheqësin e Njësisë në kuadër të së cilës veprojnë, për Miratim/Refuzim të kërkesës.

4. Pas pranimit të Rekomandimit me rastet e përzgjedhura si përfitues nga ana e Komisionit, Drejtori i Drejtorisë/Udhëheqësi i Njësisë përgatitë Propozim-Vendimin për Kryetarin e Komunës, dhe e përcjell atë te Kryetari me qëllim të Vendimmarrjes së bashku me shkresat e lëndës.

5. Kërkesat që nuk i plotësojnë kriteret për subvencione dhe transfere pa Thirrje Publike do të refuzohen nga Drejtori i Drejtorisë/Udhëheqësi i Njësisë, me Rekomandim të Komisionit.

#### **Neni 10**

##### **Vlerësimi i kërkesave dhe vendimmarrja për ndarjen e subvencioneve, transfereve dhe granteve me Thirrje Publike**

1. Komisionet bëjnë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, transfereve dhe granteve brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh pas përfundimit të mbylljes së Thirrjes Publike.

2. Vendimet e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, transfereve dhe granteve merren në bazë të pikëve të fituara sipas kriterëve të Thirrjes Publike, dhe i njëjti duhet të mbaj Procesverbal nga mbledhjet e saj i cili duhet të nënshkruhet nga Komisioni.

3. Komisionet vlerësuese të cilat veprojnë duke u bazuar në Thirrjen Publike, pas shqyrtimit të kërkesave/projekteve/planit ideor duke u bazuar në kriteret e Thirrjes Publike, marrin Vendim për Miratim/Refuzim të atyre kërkesave/projekteve, i cili Vendim publikohet në ueb faqen e Komunës dhe Tabelën e Shpalljeve.

4. Pas kalimit të periudhës së ankesave, lista e përfituesve të subvencioneve, transfereve dhe granteve, së bashku me Marrëveshjet/Kontratat e hartuara nga Njësia përkatëse e cila e ka proceduar Thirrjen Publike, i dorëzohet Kryetarit të Komunës me qëllim të lidhjes së Kontratës/Marrëveshjes me përfituesit.

#### **Neni 11**

##### **Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve, transfereve dhe granteve me Thirrje Publike**

1. Kryetari i Komunës emëron Komisionin për shqyrtimin e ankesave, në nivel të Komunës me mandat 1 (një) vjeçar, i cili shqyrton ankesat e palëve të pakënaqura nga vlerësimi i Komisionit vlerësues të cilët parashtrajnë ankesë pas publikimit të listës me përfituesit e përzgjedhur.

2. Kryetari dhe anëtarët të Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve, transfere dhe granteve duhet të jenë shërbyes civil.
3. Komisioni do të jetë në përbërje numër tek, ku komisioni i ankesave duhet të ketë minimum 3 (tre) dhe maksimum 5 (pesë) anëtar, dhe i njëjti duhet të mbajë Procesverbal nga mbledhjet e saj i cili duhet të nënshkruhet nga Komisioni.
4. Përbërja e Komisionit duhet të bazohet mbi parimin e barazisë gjinore, dhe 1 (një) anëtar i Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarjen e subvencioneve duhet të jetë Zyrtar Ligjor.
5. Anëtar të Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve, transfereve dhe granteve nuk mund të jenë zyrtarët të cilët kanë qenë pjesë e Komisioneve për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve dhe granteve.

## **Neni 12**

### **Parashtrimi dhe zgjidhja e ankesave**

1. Ankesa parashtrohet në afat prej 5 (pesë) ditë pune pas publikimit të Njoftimit/Vendimit të Komisionit Vlerësues me listën e përfituesve.
2. Komisioni duhet të bëjë shqyrtimin e ankesave të cilat parashtrihen nga palët e pakënaqura me Vendimin e Komisionit Vlerësues, dhe të marrë Vendim në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas përfundimit të afatit kohor për paraqitje të ankesave.
3. Komisioni për ankesa gjatë Vendimmarrjes vepron në bazë të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kriteret e Thirrjes Publike, dhe dispozitave të kësaj Rregulloreje.
4. Vendimet e Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve janë përfundimtare në Procedurën Administrative.

## **Neni 13**

### **Zbatimi i Vendimit/Kontratës**

1. Vendimi për ndarjen e subvencioneve, transfereve dhe granteve bëhen të zbatueshme nëse:
  - 1.1. Nuk është paraqitur ankesë sipas nenit 11, paragrafi 1.
  - 1.2. Me Vendimin e Komisionit të ankesave refuzohet ankesa.



#### **Neni 14**

#### **Thirrja Publike për ndarjen e Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve**

1. Procesi i ndarjes së subvencioneve, transfereve dhe granteve fillon përmes Thirrjes Publike të cilat publikohen në ueb faqen e Komunës dhe Tabelën e Shpalljeve të Komunës.
2. Lejimin e Thirrjes Publike për ndarjen e subvencioneve, transfereve dhe granteve në kuadër të Drejtorisë/Njesisë e lejon Kryetari i Komunës me Vendim, pas arsytimit të kërkesës për një Thirrje të tillë nga Njësia kërkuese.
3. Në Thirrje përcaktohen qartë kriteret dhe procedurat për të aplikuar ndarjen e subvencioneve, transfereve dhe granteve të cilat përcaktohen sipas kësaj rregulloreje.
4. Thirrja Publike qëndron e publikuar 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e shpalljes.

#### **Neni 15**

#### **Marrëveshja/Kontrata për Subvencione, Transfere dhe Grante në bazë të Thirrjes Publike**

1. Për realizimin e ndarjes së subvencioneve, transfereve dhe granteve duhet të lidhet një Marrëveshje/Kontratë me të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ndërmjet komunës dhe përfituesit të subvencionit/transferit/grantit.
2. Marrëveshja/Kontrata duhet të përcaktojë subjektet nënshkruese të saj, qëllimin, shumën e mjeteve financiare, afatet kohore, detyrat dhe përgjegjësitë e palëve, mbikëqyrjen, formën e subvencionimit, raportimin, hyrjen në fuqi, si dhe pjesë tjera relevante për kontratën-raport.
3. Nëse me fajin e përfituesit nuk përmbushen obligimet e përcaktuara në Marrëveshje/Kontratë për Ndarje të Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, përfituesi humb të drejtën në përfitim për 3 (tre) vitet e ardhshme nga ajo njësi që ka qenë përfitues.

#### **PJESA E DYTË**

#### **SUBVENCIONET DHE TRANSFERET NË ZYRËN E KRYETARIT**

#### **Neni 16**

#### **Subvencionet dhe transferet për persona fizik**

1. Kryetari i Komunës emëron Komisionin i cili bën shqyrtimin e kërkesave të parashtruara për subvencionim nga personat fizik në kuadër të Zyrës së Kryetarit.

2. Kryetari i Komunës, në raste të veçanta, sipas kërkesës së arsyetuar të palës, dhe Rekomandimit të Komisionit, ndan ndihmë momentale për personat fizik, duke u bazuar në këto kritere;

2.1. Për raste të cilët ballafaqohen me varfëri të skajshme;

2.2. Për persona që vuajnë nga ndonjë sëmundje e rëndë dhe për të cilët është një kosto e lartë e mjekimit;

2.3. Për personat të cilët përfaqësojnë Komunën në ndonjë garë ndërkombëtare, si në fushën e shkencës, kulturës, muzikës apo sportit.

#### **Neni 17**

#### **Dokumentet e nevojshme për aplikim**

1. Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione dhe transfereve në Zyrën e Kryetarit përfshijnë, por pa u kufizuar:

1.1 Kërkesa e palës;

1.2 Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;

1.3 Konfirmimi i bankës me numrin e xhirrollogarisë bankare në emër të përfituesit apo familjarit të tij;

1.4 Dëshminë e gjendjes civile që konfirmon lidhjen familjare;

1.5 Dëshmia mbi statusin social;

1.6 Raportin mjekësor dhe dëshminë mbi koston e mjekimit;

1.7 Konfirmimi i pjesëmarrjes së personit fizik në gara.

2. Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Kryetari i Komunës, pas pranimit të Rekomandimit të Komisionit.

### **PJESA E TRETË**

### **SUBVENCIONET DHE TRANSFERET E ZYRËS KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM**

#### **Neni 18**

#### **Subvencionet dhe transferet për persona fizik**

1. Kryetari i Komunës me kërkesën e Udhëheqësit të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, emëron Komisionin i cili bën shqyrtimin e kërkesave të parashtruara nga personat fizik që janë nga radhët e komuniteteve pakicë, të cilët aplikojnë për subvencionim në kuadër të kësaj zyre.

2. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim bën ndarjen e pakove ushqimore dhe hixhenike për familjet nga radhët e komuniteteve pakicë, duke përfshirë por pa u kufizuar në këto dokumente;

- 2.1 Kërkesa e palës;
- 2.2 Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;
- 2.3 Dëshmia mbi statusin social.

3. Ndarja e pakove ushqimore dhe hixhenike bëhet në vlerë të barabartë për të gjithë përfituesit, të cilat blihen nga Operatori Ekonomik i përzgjedhur me procedurë të Prokurimit.

## **PJESA E KATËRT**

### **SUBVENCIONET DHE TRANSFERET NË FUSHËN E ARSIMIT**

#### **Neni 19**

#### **Subvencionet dhe transferet për arsim**

1. Kryetari i Komunës me kërkesën e Drejtorit të Drejtorisë për Arsim, emëron Komisionin i cili bën shqyrtimin e kërkesave të parashtruara nga personat fizik që aplikojnë për subvencionim në fushën e arsimit.
2. Komuna mund të ndaj subvencione dhe transfere për arsim duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
  - 2.1. Bursa për Student;
  - 2.2. Bursa për Nxënës në Shkolla të Mesme – Nxënës të ekselencës (Gjimnaz, Mjekësi dhe Ekonomi), dhe Nxënës të Shkollës së Mesme në Teknikë në profilet e tregut të punës;
  - 2.3. Bursa për Nxënës në Shkolla Fillore – Nxënës me talente të veçanta;
  - 2.4. Nxënësit me Nevoja të Veçanta (transporti);
  - 2.5. Kuadrot Deficitare;
  - 2.6. Gara apo Kuize (aktivitete jashtë mësimore);
  - 2.7. Botimin e Librave/Revistave;
  - 2.8. Nxënësit që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
  - 2.9. Mësimdhënësit që kanë treguar rezultate në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.
3. Ndarja e Bursave për Student bëhet konform dispozitave të Rregullores Komunale mbi Kriteret për Ndarjen e Bursave dhe aktet tjera në fuqi nga fusha relevante.
4. Kriteret për Bursa për Nxënës të ekselencës (Gjimnaz, Mjekësi dhe Ekonomi), dhe për Nxënës të Shkollës së Mesme Teknike në profilet e tregut të punës do të rregullohen me rregullore të veçantë.
5. Kriteret për Bursa për Nxënës të Shkollave Fillore do të rregullohen me akt të veçantë.
6. Kriteret për Mësimdhënësit që kanë treguar rezultate në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar do të rregullohen me rregullore të veçantë.

7. Drejtoria e Arsimit organizon gara dhe kuize nga fushë-veprimtaria e saj me qëllim të lehtësimit dhe kreativitetit të mësimit.

#### **Neni 20**

#### **Kriteret, kushtet dhe dokumentet për përfitim të subvencioneve dhe transfereve për pagesën e transportit për nxënësit me nevoja të veçanta**

1. Kriteret, kushtet dhe dokumentet që duhet të kompletohen për të qenë përfitues i subvencioneve dhe transfereve për pagesën e transportit për nxënësit me nevoja të veçanta, përfshijnë por pa u kufizuar:
  - 1.1 Kërkesa e palës;
  - 1.2 Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;
  - 1.3 Certifikata e lindjes së fëmiut;
  - 1.4 Dëshminë e gjendjes civile që konfirmon lidhjen familjare;
  - 1.5 Diagnoza e mjekut specialist;
  - 1.6 Dokumenti që dëshmon që fëmiu vijon mësimin minimum 1 km (një kilometër) larg nga vendi i banimit;
  - 1.7 Konfirmimi i bankës me numrin e xhirrollogarisë bankare në emër të përfituesit apo familjarit të tij;
  - 1.8 Vërtetimi i shkollës në të cilën e vijon mësimin.

2. Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Drejtori i Drejtorisë, pas pranimit të Rekomandimit të Komisionit.

#### **Neni 21**

#### **Kriteret dhe kushtet për përfitim të subvencioneve dhe transfereve për nxënësit që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar**

1. Kriteret dhe dokumentet që duhet të kompletohen për të qenë përfitues i subvencioneve dhe transfereve në fushën e arsimit për nxënësit që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar përfshijnë por pa u kufizuar, si në vijim:
  - 1.1 Kërkesa e palës;
  - 1.2 Certifikata e lindjes;
  - 1.3 Dëshminë e gjendjes civile që konfirmon lidhjen familjare;
  - 1.4 Vërtetimi mbi suksesin e arritur në ndonjë garë kombëtare apo ndërkombëtare;
  - 1.5 Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës në emër të prindit;
  - 1.6 Konfirmimi i bankës me numrin e xhirrollogarisë në emër të përfituesit apo familjarit të tij.
2. Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Drejtori i Drejtorisë, pas pranimit të Rekomandimit të Komisionit.

## **Neni 22**

### **Krieteret dhe kushtet për përfitim të subvencioneve dhe transfereve për Nxënësit dhe Studentët të Kuadrove Deficitare**

- 1.** Krieteret dhe dokumentet që duhet të kompletohen për të qenë përfitues i subvencioneve dhe transfereve për Nxënësit dhe Studentët e Kuadrove Deficitare, përfshijnë por pa u kufizuar, si në vijim:
  - 1.1** Kërkesa e palës;
  - 1.2** Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës, apo Certifikata e Lindjes për Nxënës;
  - 1.3** Dëshmia mbi shkollimin që vërteton që është duke ndjekur Shkollën e Mesme, Studimet Bachelor apo Master në ndonjë drejtim deficitar;
  - 1.4** Drejtime deficitare konsiderohen, fushat e shkencave të natyrës, matematikë, ingjinerike dhe teknike;
  - 1.5** Konfirmimi i bankës me numrin e xhirollogarisë në emër të përfituesit apo familjarit të tij;
  - 1.6** Dëshminë e gjendjes civile që konfirmon lidhjen familjare.
  
- 2.** Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Drejtori i Drejtorisë, pas pranimit të Rekomandimit të Komisionit.

## **Neni 23**

### **Krieteret dhe kushtet për përfitim të subvencioneve dhe transfereve për Botim të Librave dhe Revistave**

- 1.** Krieteret dhe dokumentet që duhet të kompletohen për të qenë përfitues i subvencioneve dhe transfereve në fushën e arsimit për botim të Librave dhe Revistave, përfshijnë por pa u kufizuar, si në vijim:
  - 1.1** Kërkesa e palës;
  - 1.2** Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;
  - 1.3** Dëshmia e Shtëpisë Botuese mbi koston botimit të Librës/Revistës;
  - 1.4** Arsyeshmëria e rëndësisë së botimit të atij Libri/Reviste;
  - 1.5** Konfirmimi Bankës me numrin e xhirollogarisë vetëm në emër të përfituesit;
  - 1.6** Dëshminë e gjendjes civile që konfirmon lidhjen familjare.
  
- 2.** Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Drejtori i Drejtorisë, pas pranimit të Rekomandimit të Komisionit.

**PJESA E PESTË**  
**SUBVENCIONET DHE GRANTET NË FUSHËN E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE**  
**TURIZMIT**

**Neni 24**

**Subvencionet, transfere dhe grante për zhvillim ekonomik, punësim dhe turizëm**

1. Kryetari i Komunës me kërkesën e Drejtorit të Drejtorisë për Zhvillim, Ekonomi, Turizëm dhe Integritet Evropian, emëron Komisionin i cili bën shqyrtimin e kërkesave të parashtruara nga personat fizik dhe juridik, të cilët parashtrojnë kërkesë për subvencione dhe transfere në fushën e ekonomisë dhe turizmit pa Thirrje Publike.
2. Komuna ndan subvencione, transfere dhe grante në fushën e zhvillimit ekonomik, punësimin dhe turizmit për personat fizik dhe juridik në rastet si në vijim:
  - 2.1. Grante për biznese fillestare (StartUP);
  - 2.2. Grante dhe subvencione për bizneset ekzistuese;
  - 2.3. Trajnimi dhe Praktikë në punë;
  - 2.4. Promovim të prodhimeve vendore;
  - 2.5. Ndërmarrjet Publike Lokale;
  - 2.6. Aktivitetet e shoqatave të cilat ndihmojnë dhe promovojnë zhvillimin ekonomik dhe turizmin.

**Neni 25**

**1. Subvencione, transfere dhe grante për Biznese Fillestare (StartUP)**

1. Komuna ndan subvencione, transfere dhe grante për bizneset fillestare (StartUP) që u ofrohen personave fizik dhe juridik me ide kreative dhe të arsyetuara mirë të cilat kontribuojnë në zhvillim ekonomik dhe punësim.
2. Subvencionet, transferet dhe grantet për bizneset fillestare ofrohen në bazë të Planit të Punës së Drejtorisë e cila inicohet me Thirrje Publike, e cila përpilohet sipas kushteve dhe nevojave të arritjes së objektivave të zhvillimit ekonomik.
3. Kriteret dhe dokumentet që duhet të kompletohen dhe kushtet që duhet të plotësohen për të qenë përfitues i subvencioneve, transfereve dhe granteve për biznese fillestare, përfshijnë por pa u kufizuar:
  - 3.1 Formulari i aplikimit;
  - 3.2 Model - Plani i Biznesit;
  - 3.3 Dokumenti Valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;
  - 3.4 Certifikata e vendbanimit;
  - 3.5 Dëshmi të shkollimit, trajnimeve dhe përvojës;
  - 3.6 Vërtetimin e tatimit në pronë;

3.7 Dëshminë që mund të jenë në gjendje të vërtetojnë se do të financojnë me paratë e tyre të paktën 20% (njëzetë përqind) të vlerës, për bizneset e reja (nëse kërkohet).

4. Individët që kanë fituar më parë subvencione, transfere dhe grante nga komuna, pushteti qëndror ose nga ndonjë donator tjetër gjatë vitit të njëjtë kalendarik do të diskualifikohen.

5. Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Komisioni Vlerësues.

## **Neni 26**

### **Subvencione, Transfere dhe Grante dhe për Biznese Ekzistuese**

1. Komuna ndan subvencione, transfere, dhe grante për bizneset ekzistuese për personat juridik me ide kreative dhe të arsyetuara mirë me qëllim të rritjes së prodhimit, punësimit dhe të cilat kontribuojnë në zhvillim ekonomik lokal.

2. Subvencionet, transferet dhe grantet për biznese ekzistuese ofrohen në bazë të Planit të Punës së Drejtorisë e cila inicohet me Thirrje Publike, e cila përpilohet sipas kushteve dhe nevojave të arritjes së objektivave të zhvillimit ekonomik.

3. Kriteret, kushtet dhe dokumentet që duhet të kompletohen dhe duhet të plotësohen për të qenë përfitues i subvencioneve, transfereve dhe granteve për biznese ekzistuese, përfshijnë por pa u kufizuar:

3.1 Formulari i aplikimit;

3.2 Model - Plani i Biznesit;

3.3 Dokumenti Valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;

3.4 Certifikata e vendbanimit;

3.5 Dëshmi për pagesën e taksave komunale;

3.6 Vërtetimi tatimor nga ATK;

3.7 Certifikatën e ARBK-së;

3.8 Dëshmi të shkollimit, trajnimeve dhe përvojës;

3.9 Dëshminë që vërtetojnë se mund të jenë në gjendje të financojnë me paratë e tyre të paktën 20% të vlerës (nëse kërkohet).

4. Bizneset që kanë fituar më parë subvencione, transfere apo grante nga komuna, pushteti qëndror, ose nga ndonjë donator tjetër gjatë vitit të njëjtë kalendarik do të diskualifikohen.

5. Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Komisioni Vlerësues.

## **Neni 27**

### **Trajnimi dhe Praktikë në punë**

1. Komuna mund të ofrojë trajnime në punë për të papunësuarit të regjistruar si punë kërkuar, të cilët janë të diplomuar nga insitucionet e arsimit të mesëm dhe të lartë, dhe janë të papunë në periudhë afatgjate.
2. Punëdhënësit nga sektori privat, sektori publik, ndërmarrjet publike dhe OJQ-të mund të jenë bashkë pjesëmarrës në këtë proces, të cilët shprehin interesimin e tyre për të hyrë në partneritet për të angazhuar praktikantë me pagesë.
3. Kohëzgjatja e trajnimit dhe praktikës në punë mund të jetë nga 2 (dy) deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj, jo më shumë se 40 (dyzetë) orë në javë, dhe e njëjta ofrohet në bazë të Planit të Drejtorisë dhe inicohet me Thirrje Publike, e cila përpilohet sipas kushteve dhe nevojave të arritjes së objektivave të zhvillimit ekonomik.
4. Kriteret dhe kushtet që duhet të plotësohen për të qenë përfitues i punës praktike me pagesë janë:
  - 4.1 I papunësuar duhet të jetë i regjistruar si punë kërkuar të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit pas diplomimit;
  - 4.2 Dëshminë që është banor rezident i Komunës së Mitrovicës Veriore;
  - 4.3 Dëshminë mbi përfundimin e shkollimit të mesëm apo të lartë;
  - 4.4 Lista e punëkërkuarve merret në Institucionin përkatës.
5. Të përzgjedhurit për punë praktike me pagesë mund të marrin një kompensim në formë të ndihmës financiare, jo më të ultë se 70% (shtatëdhjetë përqind) të pagës minimale, e cila pagesë bëhet me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të trajnimit apo praktikës, i cili kompensim bëhet në xhironlogarinë e përfituesit.
6. I papunësuar i regjistruar nuk mund të jetë përfitues i punës praktike me pagesë më shumë se 1 (një) herë brenda 3 (tre) viteve.
7. Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Komisioni Vlerësues.

## **Neni 28**

### **Promovim të prodhimeve vendore**

1. Komuna përkrah promovimin e prodhimeve vendore për personat fizik dhe juridik për pjesëmarrje, ekspozim dhe promovim të prodhimeve vendore ne eventet dhe panairët brenda dhe jashtë vendit.



2. Ndarja e subvencioneve dhe transfereve për promovim të prodhimeve vendore bëhet në bazë të kërkesës së palës.

3. Kushtet dhe kriteret për të qenë përfitues i subvencioneve dhe transfereve për promovim të prodhimeve vendore përfshijnë dokumentet por pa u kufizuar, si në vijim:

3.1 Formulari i aplikimit;

3.2 Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;

3.3 Ftesa për pjesëmarrje në panair/konferencë;

3.4 Kostoja e pjesëmarrjes;

3.5 Certifikata e vendbanimit;

3.6 Dëshmi për pagesën e taksave komunale;

3.7 Vërtetimi tatimor nga ATK;

3.8 Prodhimet dhe produktet duhet të jenë të prodhuara në territorin e Komunës së Mitrovicës Veriore.

4. Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Drejtori i Drejtorisë, pas pranimit të Rekomandimit të Komisionit.

## **Neni 29**

### **Ndërmarrjet Publike Lokale**

Ndërmarrjet publike lokale mund të subvencionohen duke u bazuar në autorizimet që vijnë nga Ligji Vjetor mbi Ndarjen Buxhetore apo ndonjë Ligj tjetër të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ku subvencionimi do të bëhet në përputhje me dipozitat e atij Ligji dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

## **Neni 30**

### **Aktivitetet e Shoqatave të cilat ndihmojnë dhe promovojnë zhvillimin ekonomik dhe turizmin**

1. Komuna përkrah aktivitetet e shoqatave të cilat ndihmojnë dhe promovojnë zhvillimin ekonomik dhe turizmin bazuar në Planin e Drejtorisë dhe Thirrjes Publike, e cila përpilohet sipas kushteve dhe nevojave të arritjes së objektivave të zhvillimit ekonomik.

2. Ndarja e subvencioneve për OJQ-të (shoqatat) që promovojnë zhvillimin ekonomik dhe turizmin do të bëhet sipas Rregullores MF-04/2017, mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

**PJESA E GJASHTË**  
**SUBVENCIONET, TRANSFERET DHE GRANTET NË FUSHËN E BUJQËSISË,**  
**ZHVILLIMIT DHE TURIZMIT RURAL**

**Neni 31**

**Subvencionet, transferet dhe grantet për bujqësi dhe zhvillim rural**

1. Kryetari i Komunës me kërkesën e Drejtorit të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, emëron Komisionin i cili bën shqyrtimin e kërkesave të parashtruara nga personat fizik që aplikojnë për subvencione, transfere dhe grante në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, kur kemi kërkesa pa Thirrje Publike.
2. Komuna mund të ndaj subvencione, transfere dhe grante për bujqësi dhe zhvillim rural me kërkesë të palës apo me Thirrje Publike duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
  - 2.1 Projekte të fermerëve, shoqatave, kooperativat bujqësore në sektorin e bujqësisë me prioritet për komunën;
  - 2.2 Organizimin e panairëve, seminareve, vizitave studimore;
  - 2.3 Mbështetjen e projekteve me bashkëfinancim me donatorët;
  - 2.4 Mbështetjen e projekteve për zhvillim dhe turizëm rural;
  - 2.5 Ndarja e paisjeve dhe mekanizimit bujqësor;
  - 2.6 Ngritja e serrave;
  - 2.7 Projekteve në fushën e pemëtarisë;
  - 2.8 Projekteve në fushën e lavërtarisë dhe perimtarisë;
  - 2.9 Projekteve në fushën e blegtorisë dhe bletarisë;
  - 2.10 Projekteve në fushën e bimëve mjeksore;
  - 2.11 Rastet e fatkeqësive që prekin fermerët;
  - 2.12 Pagesa direkte për sipërfaqet e mbjellura me drithëra;
  - 2.13 Pagesa direkte për lopë, dele dhe dhi qumështore;
  - 2.14 Pagesa direkte për bletë;
  - 2.15 Pagesa direkte për qumësht/litër sipas kategorive dhe cilësisë.
3. Ndarja e subvencioneve për OJQ-të (shoqatat) në fushën e bujqësisë dhe turizmit rural do të bëhet sipas Rregullores MF-04/2017, mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
4. Gjatë ndarjes së subvencioneve, transfereve dhe granteve duke përfshirë por pa u kufizuar, grantet me ngritje të serave, furnizim me mekanizëm bujqësisë, projekte të ndryshme në fushën e blegtorisë, bletarisë, pemëtarisë, perimtarisë, lavërtarisë, bimëve mjekësore, dhe fusha tjera të ngjashme, drejtoria obligohet që pas lejimit nga Kryetari i Komunës për lejim të mjeteve dhe inicimin e Thirrjes Publike, të inicioj procedurat e Prokurimit në përputhje me

projektin/vlerën që do të realizoj për blerjen e paisjeve, mekanizmit, serrave, materialit fidanor dhe imputeve tjera bujqësore, për fermer.

5. Gjatë ndarjes së subvencioneve, transfereve dhe granteve për bujqësi dhe zhvillim rural, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi:

5.1 Zonave me prioritet të identifikuar nga Komuna;

5.2 Grave, të rinjëve dhe të rejave, personave me nevoja të veçanta dhe status të veçantë;

5.3 Aplikantëve që nuk kanë fituar më parë subvencione, transfere dhe grante nga komuna gjatë vitit të njëjtë fiskal, dhe nuk kanë qenë përfitues i një subvencioni për bujqësi të ndarë nga pushteti qendror, apo nga ndonjë donator tjetër, me përjashtim të pagesave direkte.

### **Neni 32**

#### **Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione, transfere dhe grante në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural me Thirrje Publike**

1. Kushtet, kriteret dhe dokumentet për të qenë përfitues i subvencioneve, transfereve dhe granteve duke u bazuar në kriteret e Thirrjes Publike, përfshijnë por pa u kufizuar dokumentet si në vijim:

1.1 Formulari i aplikimit;

1.2 Numri identifikues i fermerit (NIF);

1.3 Certifikatën e biznesit (nëse funksionon si biznes dhe nëse kërkohet);

1.4 Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;

1.5 Certifikata e pronës;

1.6 Projektin dhe planin financiar ;

1.7 Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;

1.8 Konfirmimin nga banka me numrin e xhirollogarisë së aplikuesit;

1.9 Vërtetimi tatimor nga ATK ;

1.10 Deklaratën se nuk është përfitues i grantit të ndarë nga pushteti qendror apo lokal në këtë fushë brenda viti fiskal, përjashtimisht pagesat direkte.

2. Ndarja e subvencioneve, transfereve dhe granteve bëhet në bazë të Thirrjes Publike në të cilën përcaktohen kriteret dhe dokumentacioni i nevojshëm për aplikim.

3. Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Komisioni Vlerësues.

### **Neni 33**

#### **Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione dhe transfere në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural në rastet e fatkeqësive tek fermerët pa Thirrje Publike**

1. Kushtet dhe kriteret për të qenë përfitues i subvencioneve dhe transfereve me kërkesë të palës, përfshijnë por pa u kufizuar dokumentet si në vijim:

- 1.1 Formulari i aplikimit;
- 1.2 Numrin identifikues të fermerit (NIF);
- 1.4 Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;
- 1.7 Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
- 1.8 Konfirmimin nga banka me numrin e xhirollogarisë bankare të aplikuesit;
- 1.9 Dëshminë për dëmin e shkaktuar.

2. Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Drejtori i Drejtorisë, pas pranimit të Rekomandit të Komisionit.

#### **Neni 34**

#### **Kushtet, kriteret dhe dokumentet e nevojshme që duhet plotësuar për subvencione dhe transfere në Pagesa Direkte për sipërfaqe të mbjellura me drithëra**

1. Dokumentet e nevojshme për aplikim për pagesa direkte për sipërfaqe të mbjellura me drithëra janë, por pa u kufizuar:

- 1.1 Dokumentin valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;
- 1.2 Numri Identifikues i Fermerit (NIF);
- 1.3 Certifikatën e Pronës;
- 1.4 Dëshmi mbi pagesën e tatimit në pronë;
- 1.5 Kontratën e qirasë (nëse është prona e marrur me qira);
- 1.6 Konfirmimin bankar me numrin e xhirollogarisë në emër të aplikuesit;
- 1.7 Deklaratën nën Betim për sipërfaqën dhe vendin e mbjellur me drithëra (nga Noteri).

2. Ndarja e subvencioneve dhe transfereve për pagesa direkte për subvencionim për sipërfaqe të mbjellura me drithëra bëhet në bazë të Thirrjes Publike në të cilën përcaktohen kriteret dhe dokumentacioni i nevojshëm për aplikim për subvencionim.

3. Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Komisioni.

#### **Neni 35**

#### **Kushtet, kriteret dhe dokumentet e nevojshme që duhet plotësuar për subvencione dhe transfere për Pagesa Direkte për qumësht/litër**

1. Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për Pagesa Direkte për qumësht/litër, janë por duke mos u kufizuar:

- 1.1 Formulari i aplikimit;
- 1.2 Numrin identifikues të fermerit (NIF);
- 1.3 Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;
- 1.4 Konfirmimi bankar me numrin e xhirollogarisë së aplikuesit;
- 1.5 Kopja e listës së verifikimit të kafshëve: gjedhet, dhentë dhe dhitë, të lëshuar nga Sektori për identifikim dhe regjistrim në kuadër të AUV-së;

**1.6** Kopja e kontratës, e vërtetuar nga noteri, për furnizim me qumësht, të lëshuar nga qumështoret e licencuara ose në ndonjëra nga pikat e grumbullimit të qumështit si biznese, të cilat kanë kontratë me ndonjërin qumështore të licencuar;

**1.7** Dëshmia për sasinë e qumështit të dorëzuar në qumështore ose pikën grumbulluese të qumështit;

**1.8** Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;

**1.9** Të ofrojnë dëshmi të lëshuar nga laboratorit i AUV për cilësinë e qumështit të dorëzuar në ndonjërin nga pikat e grumbullimit të qumështit si biznese, të cilat kanë kontratë me ndonjërin nga qumështoret e licencuara;

**1.10** Të kenë kontratë, të vërtetuar nga Noteri për shitjen e qumështit në ndonjërin nga pikat e grumbullimit të qumështit si biznese, të cilat kanë kontratë me ndonjërin nga qumështoret e licencuara;

**1.11** Të ofrojnë dëshmi bankare për sasinë mujore të qumështit të shitur;

**1.12** Të kenë dorëzuar së paku 2,000.00 (dymijë) lirta qumësht dhe më së shumti deri në 30.000.00 (tridhjetë mijë) lirta qumësht për 6 (gjashtë) muaj.

**2.** Ndarja e subvencioneve dhe transfereve për pagesa direkte për qumësht/litër bëhet në bazë të Thirrjes Publike në të cilën përcaktohen kriteteret dhe dokumentacioni i nevojshëm për aplikim për subvencionim.

**3.** Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Komisioni.

### **Neni 36**

#### **Kushtet, kriteret dhe dokumentet e nevojshme që duhet plotësuar për subvencione dhe transfere për Pagesa Direkte për krerë, lopë, dele dhe dhi qumështore**

**1.** Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për Pagesa Direkte- për krerë lopë, dele dhe dhi qumështore, janë por duke mos u kufizuar:

**1.1** Formulari i aplikimit;

**1.2** Numrin identifikues të fermerit (NIF);

**1.3** Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;

**1.4** Konfirmimi bankar me numrin e xhirollogarisë bankare të aplikuesit;

**1.5** Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;

**1.6** Regjistri lëshuar nga Praktikat Veterinare të kontraktura nga AUV, duke u bazuar në të dhënat e sistemit të Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV, i cili duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur në të gjitha fletët/faqet.

**2.** Ndarja e subvencioneve dhe transfereve për pagesa direkte për krerë lopë, dele, dhi qumështore bëhet në bazë të Thirrjes Publike në të cilën përcaktohen kriteteret dhe dokumentacioni i nevojshëm për aplikim për subvencionim.

3. Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Komisioni.

#### **Neni 37**

#### **Kushtet, kriteret dhe dokumentet e nevojshme që duhet plotësuar për subvencione dhe transfere për Pagesa Direkte për Shoqëri bletësh**

1. Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për Pagesa Direkte për Shoqëri bletësh janë, por duke mos u kufizuar:

1.1 Formulari i aplikimit;

1.2 Numrin identifikues të fermerit (NIF);

1.3 Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;

1.4 Konfirmimi nga banka për xhirlogarinë bankare të aplikuesit;

1.5 Dëshmi individuale nga ana e vet fermerit për numrin e shoqërive të bletëve dhe vendndodhjen e shoqërive të bletëve, e cila duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga Drejtoria Komunale përkatëse për Bujqësi – Komuna;

1.6 Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;

1.7 Në momentin e kontrollit të fermerit/aplikuesit, në rast se i mungon numri Identifikues i Fermës (NIF) në koshere, atëherë përjashtohet nga subvencionimi secila koshere pa numrin Identifikues të fermës (NIF) të shënuar.

2. Ndarja e subvencioneve dhe transfereve për pagesa direkte për Shoqëri bletësh bëhet në bazë të Thirrjes Publike në të cilën përcaktohen kriteret dhe dokumentacioni i nevojshëm për aplikim për subvencionim.

3. Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Komisioni.

#### **PJESA E SHTATË**

#### **SUBVENCIONET DHE TRANSFERET NË FUSHËN E SHËNDETËSISË**

#### **Neni 38**

#### **Subvencionet dhe transferet për shëndetësi**

1. Kryetari i Komunës me kërkesën e Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi, emëron Komisionin i cili bën shqyrtimin e kërkesave të parashtuara nga personat fizik që aplikojnë për subvencione dhe transfere në fushën e shëndetësisë.

2. Komuna ndan subvencione dhe transfere për qytetarët të cilët janë banor rezident të Komunës së Mitrovicës Veriore, për përballimin e shpenzimeve të shërimit, sipas kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria për Shëndetësi.

3. Subvencionet dhe transferet nga Drejtoria e shëndetësisë ofrohen për këto raste:

3.1 Rastet e rënda me probleme të mëdha shëndetësore;

3.2 Fëmijët me probleme shëndetësore, ngecje fizike dhe probleme psikike;

3.3 Rastet të sëmundjeve kronike, në kushte jo të mira ekonomike.

4. Gjatë ndarjes së subvencioneve dhe transferet në shëndetësi, në kushte të barabarta, u ipet përparësi rasteve specifike në vijim:

4.1 Rastet e sapo të diagnostifikuara me sëmundjet malinje;

4.2 Koston e trajtimit;

4.3 Gjendjen ekonomike familjare;

4.4 Trajtimin ne institucionet private vendore dhe jashtë vendit, nëse një sëmundje e tille nuk mund te trajtohet ne institucionet publike ose kur në institucionet publike mungon terapia e nevojshme.

#### **Neni 39**

### **Krieteret, kushtet dhe dokumentacioni për përfitim të subvencioneve dhe transfereve në Drejtorinë e Shëndetësisë**

1. Kriteret për të qenë përfitues i subvencioneve dhe transfereve në fushën e shëndetësisë, përfshijnë por pa u kufizuar dokumentet si në vijim:

1.1 Kërkesa e palës;

1.2 Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;

1.3 Dëshmia e gjendjes shëndetësore nga mjeku specialist;

1.4 Dëshmia mbi koston e trajtimit;

1.5 Dëshmia mbi gjendjen ekonomike;

1.6 Konfirmimi bankar me numrin e xhirollogarisë në emër të përfituesit apo familjarit të tij;

1.7 Dëshminë e gjendjes civile që konfirmon lidhjen familjare.

2. Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Drejtori i Drejtorisë, pas pranimit të Rekomandimit të Komisionit.

#### **PJESA E TETË**

### **SUBVENCIONET DHE TRANSFERET NË FUSHËN E MIRËQENIES SOCIALE**

#### **Neni 40**

### **Subvencionet dhe transferet për mirëqenie sociale**

1. Kryetari i Komunës me kërkesën e Drejtorit të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, emëron Komisionin i cili bën shqyrtimin e kërkesave të parashtruara nga personat fizik që janë në gjendje të rëndë ekonomike dhe financiare, të cilët aplikojnë për subvencione dhe transfere në kuadër të kësaj drejtorie.

2. Drejtoria për Mirëqenie Sociale ndan ndihmë financiare – subvencione dhe transfere nga buxheti i saj, duke u bazuar në këto kritere, por pa u kufizuar;

2.1. Për raste të cilët ballafaqohen me varfëri të skajshme;

2.2. Për familjet të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit, jetojnë me qera dhe në gjendje jo të mirë financiare.

3. Ndarja e subvencioneve për OJQ-të (shoqatat) në fushën e mirëqenies sociale do të bëhet sipas Rregullores MF-04/2017, mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

#### **Neni 41**

#### **Dokumentet e nevojshme për aplikim**

1. Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione dhe transfere në Drejtorinë për Mirëqenie Sociale përfshijnë por pa u kufizuar:

- 1.1 Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;
- 1.2 Konfirmimi i bankës me numrin e xhirollogarisë bankare në emër të përfituesit;
- 1.3 Dëshminë e gjendjes civile që konfirmon lidhjen familjare;
- 1.4 Dëshmia mbi gjendjen ekonomike;
- 1.5 Kontrata e qirasë valide.

2. Aplikacionet të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Drejtori i Drejtorisë, pas pranimit të Rekomandimit të Komisionit.

#### **PJESA E NËNTË**

#### **SUBVENCIONET, TRANSFERET DHE GRANTET NË FUSHËN E ÇËSHTJEVE GJINORE DHE TË DREJTAT E NJERIUT**

#### **Neni 42**

#### **Subvencionet, transferet dhe grantet për çështje gjinore dhe drejta të njeriut**

1. Drejtoria për Administratë të Përgjithshme, konkretisht njësia për çështje gjinore dhe të drejtat e njeriut bëjnë ndarje të subvencioneve, transfereve dhe granteve për projekte të cilat realizohen nga OJQ-të, që promovojnë të drejtat e njeriut, të drejtat e fëmijëve, projekte që promovojnë çështjet gjinore, që nxisin vetdijësimin e qytetarëve për rëndësinë e barazisë gjinore në çdo fushë, dhe fusha të tjera të ngjashme.

2. Ndarja e subvencioneve për projektet si në paragrafin 1 (një) të këtij neni bëhet në përputhje me dispozitat e Rregullores MF-04/2017, mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

#### **PJESA E DHJETË**

#### **SUBVENCIONE DHE TRANSFERET NË FUSHËN E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT**

#### **Neni 43**

#### **Subvencionet dhe transferet për kulturë, rini, sport**

1. Kryetari i Komunës me kërkesën e Drejtorit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, emëron Komisionin i cili bën shqyrtimin e kërkesave të parashtruara nga personat fizik që aplikojnë për subvencione dhe transfere në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.



**2.** Komuna mund të ndaj subvencione dhe transfere për kulturë, rini dhe sport duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, në këto fusha:

- 2.1** Sportistët e dalluar;
- 2.2** Garat sportive individuale;
- 2.3** Festivalet;
- 2.4** Ekspozitat;
- 2.5** Aktivitete me karaktere garuese;
- 2.6** Pjesëmarrje në festivale, konferenca dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare;
- 2.7** Promovim i librave;
- 2.8** Promovim i talentëve të rinjë;
- 2.9** Vizita studimore.
  - Promovimi dhe inkurajimi i kapaciteteve të të rinjve.
  - Përfaqësimi i grave në kulturë, rini dhe sport.
  - Organizimi i tryezave të rrumbullakëta për kulturë, rini dhe sport.

#### **Neni 44**

#### **Dokumentet e nevojshme për aplikim**

**Dokumentet e nevojshme për dorëzimin e aplikacioneve për subvencione dhe transferime në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport përfshijnë, por nuk kufizohen në:**

- 1.1** Kërkesa e palës;
- 1.2** Dokument i vlefshëm identifikimi i Republikës së Kosovës;
- 1.3** Ftesë për çdo aktivitet kulturor, rinor apo sportiv brenda dhe jashtë vendit;
- 1.4** Certifikata e vendbanimit;
- 1.5** Dëshmi për pjesëmarrje në çdo festival, ekspozitë apo ngjarje sportive të natyrës konkurruese;
- 1.6** Vërtetim bankar me numër llogarie bankare në emër të përfituesit.
- 1.7** Forma dhe buxheti.
- 1.8** Regjistrimi i organizatës.
- 1.9** Dëshmi për partneritetet me ndonjë organizatë tjetër (nëse ka).
- 1.10** Regjistrimi i organizatës.
- 1.11** Auditimi i vitit të fundit të organizatës.
- 1.12** Llogaria bankare e organizatës.
- 1.13** Vërtetimi i financimit pa dublikatë.
- 1.14** Deklarata në ATK.

## **PJESA E NJËMBËDHJETË DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 45**

#### **Monitorimi i përfituesve të subvencioneve, transfereve dhe granteve**

1. Komuna/Drejtoritë/Njësitë përkatëse duhet të mbajn regjistra të detajuar të pagesave të subvencioneve, transfereve dhe granteve të ekzekutuara, ose kthimet eventuale nga këto pagesa dhe duhet të barazohen me shumat e raporteve bankare me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.
2. Komuna ka të drejtë të inicioj auditimin e përfituesve për mënyrën e shpenzimit të mjeteve të ndara nga komuna në formë të subvencioneve, transfereve dhe granteve.
3. Komuna/Njësia përkatëse që ka bërë ndarjen e subvencioneve, transfereve dhe granteve, mund të bëj monitorimin e përfituesve të subvencioneve, transfereve dhe granteve, me theks të veçantë të përfituesve në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik, në lidhje me shfrytëzimin e drejtë dhe sipas Vendimit apo Marrëveshjes të mjeteve të ndara në formë të subvencioneve dhe granteve.
4. Monitorimi sipas paragrafit 2 mund të bëhet në periudhën kohore deri në 3 (tre) vite nga data e përfitimit të subvencionit apo grantit.

### **Neni 46**

#### **Raportet kthyesë nga përfituesit e subvencioneve dhe granteve**

1. Përfituesit e subvencioneve, transfereve dhe granteve të ndara nga Komuna obligohen që në Njësinë përkatëse në të cilën kanë qenë përfitues të subvencioneve, transfereve dhe granteve, të dorëzojnë Raport Financiar dhe Narrativ.
2. Përfituesit e subvencioneve, transfereve dhe granteve obligohen që pas marrjes së subvencionit apo grantit, të dorëzojnë në Njësinë përkatëse Raportin me të gjitha shpenzimet financiare ashtu siç janë kërkuar me projekt-propozim. Raporti duhet t'i ketë të gjitha shpenzimet e dokumentuara (raportet bankare, faturat e rregullta, nënshkrimet e pjesëmarrësve, etj).
3. Përfituesit e subvencioneve, transfereve dhe granteve obligohen që pas përfitimit të subvencioneve të dorëzojnë Raportin Narrativ i cili duhet t'i ketë të gjitha të dhënat e aktiviteteve që janë realizuar gjatë zbatimit të projektit.
4. Periudha kohore e raportimit duhet të jetë 30 (tridhjetë) ditë pune pas përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në marrëveshjen në mes palës përfituese dhe komunës apo në Vendimin e Kryetarit të Komunës.

5. Raportet nga paragrafi 1 (një) i këtij neni protokollohet dhe një kopje e tyre dorëzohet në arkivin e lëndës.

**Neni 47**  
**Dispozitat shfuqizuese**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen të gjitha rregulloret e mëparshme.

**Neni 48**  
**Hyrja ne fuqi**

Kjo Rregullore shpallet 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë Përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, dhe hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës Veriore.

Mitrovicë Veriore.



**Dorëzohet:**

1x1 Kryesuesit të Kuvendit

1x1 MAPL

1x1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës

Të gjitha Drejtorive